

APLIKIMI PER LICENSE

Ka te drejte te aplikojte per nje liçense te leshuar nga ERE, çdo person qe ka selinë e tij ne Shqiperi, dhe me objekt te veprimtarise aktivitetin e kerkuar per licensim. Çdo person i huaj duhet te krijojte nje shoqeri sipas legjislacionit ne fuqi, me objekt veprimtarie aktivitetin e kerkuar per licensim nga ERE per te gjithë periudhen e vlefshmerise se liçenses.

PERGATITJA E DOSJES SE APLIKIMIT

- Aplikimi konsiston ne formatin e aplikimit dhe dokumentacionin perkates
- Aplikuesi do te kryej pagesen per aplikim ne momentin e paraqitjes se aplikimit sic percaktohet ne tabelen e meposhteme

AKTIVITETI	LICENSIM	MODIFIKIM	RINOVIM	TRANSFERIM
Prodhimin e energjiise elektrike;	30 000 LEKE / MW	50 000 LEKE	50 000 LEKE	50 000 LEKE
Operimin e Sistemit te Transmetimin e energjiise elektrike;	1 000 000 LEKE	100 000 LEKE	100 000 LEKE	100 000 LEKE
Operimin e Sistemit te Shperndarjen e energjiise elektrike;	1000 000 LEKE	100 000 LEKE	100 000 LEKE	100 000 LEKE
Furnizimin e energjiise elektrike;	1000 000 LEKE	100 000 LEKE	100 000 LEKE	100 000 LEKE
Operimin e Tregut te energjiise elektrike	1000 000 LEKE	100 000 LEKE	100 000 LEKE	100 000 LEKE
Sistetet e mbyllura te shperndarjes se energjiise elektrike	1000 000 LEKE	100 000 LEKE	100 000 LEKE	100 000 LEKE
Tregtimin e energjiise elektrike	40 000 LEKE	30 000 LEKE	30 000 LEKE	30 000 LEKE

- Dokumentacioni i paraqitur nga aplikuesi duhet te jete ne gjuhen shqipe, original ose fotokopje e noterizuar ndersa vertetimet dhe deklaratat nga organe e tjera duhet te jene leshuar jo me pare se 1 muaj nga momenti i paraqitjes se aplikimit.
- Nese aplikuesi ka aplikuar dhe eshte ne proces per marrjen e lejeve te tjera te nevojshme te percaktuara ne rregullore, mund te paraqese aplikimin ne ERE duke paraqitur informacion nga institucioni perkates per fazen ne te cilen ndodhet procesi i marrjes se lejeve nga institucionet e tjera.
- Dokumentacioni teknik sipas tipit te licenses duhet te jete i hartuar dhe sigluar nga eksperte te licensuar (ing. elektrike, ing. mekanike, eksperte kontabel, ing.hidroteknike etj.)
- Cdo aplikim i shoqeruar me dokumentacionin perkates do te paraqitet ne dykopje: nje origjinale ose fotokopje e noterizuar, dhe nje kopje elektronike e te gjithe dokumentacionit sic percaktohet nga kjo rregullore.
- Per centralet te cilat perdorin energjine valore te detit dhe/ose energjine e baticave dhe zbaticave paraqiten te njejtat dokumenta te aplikueshme si per HEC dhe ne perputhje me kuadrin ligjor.

ERE leshon tipet e licensave dhe me afat vlefshmerie sic percaktohet me poshte:

- Prodhimin e energjisë elektrike deri në 30 vjet
 - Operimin e Sistemit të Transmetimit të energjisë elektrike deri 30 vjet
 - Operimin e Sistemit të Shpërndarjes së energjisë elektrike, deri në 30 vjet
 - Furnizimin me energji elektrike, deri në 5 vjet
 - Tregtimin e energjisë elektrike, deri në 5 vjet
 - Operimin e Tregut të energjise elektrike, deri në 5 vjet
 - Sistemet e mbyllura të shperndarjes së energjise elektrike, deri në 5 vjet
- ✚ Nuk jepet licënsë për operimin e nje linje direkte në transmetim apo shpërndarje, për
- a. veteprodhuesit të cilët nuk janë të lidhur me rrjetin kombëtar,
 - b. kur lidhja me rrjetin kombëtar bëhet me qëllime të mirëmbajtjes së njësisë së tij të prodhimit,
 - c. prodhuesit, përfshirë dhe vetëprodhuesit e lidhur me rrjetin kombëtar, me kapacitet të instaluar deri në 1 MW.
- ✚ Këto subjekte në çdo rast janë të detyruar të respektojnë Rregullat e Tregut dhe Kodet e Rrjetit.

Per me teper referohuni Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike miratuar me Vendimin e Bordit të ERE nr.109, datë 29.06.2016